



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

Nr. 357/prot.
2

Tiranë, më 25.11.2025

**SHTYHET THIRRJA PËR APLIKIME PËR HARTUES TË TESTEVE TË PROVIMEVE
KOMBËTARE /
VLERËSUES TË TESTEVE TË MATURËS SHTETËRORE**

Qendra e Shërbimeve Arsimore shpall thirrjen për shprehje interesi për hartues të testeve të provimeve kombëtare / vlerësues të testeve të Maturës Shtetërore

Kriteret:

Kriteret që duhet të plotësojnë mësuesit që aspirojnë për t'u bërë hartues të testeve:

Kandidati për hartues të testeve në provimet kombëtare është mësuesi që:

- a) ushtron profesionin e mësuesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.
- b) ka të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune si mësues.
- c) ka dhënë lëndën përkatëse të paktën 1 (një) herë në të gjitha klasat e nivelit arsimor.
- d) ka të paktën kategorinë e kualifikimit "Mësues i kualifikuar" dhe është vlerësuar në provimin e kualifikimit të mësuesve me të paktën "Shumë mirë".
- e) preferohet të ketë përvojë në hartimin e pyetjeve për provimet kombëtare.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- ✓ Formular aplikimi (i cili ndodhet në seksionin njoftime në faqen e QSHA)
- ✓ Model testi të lëndës;
- ✓ Jetëshkrimin (CV e aplikantit sipas modelit Europass);
- ✓ 2 (dy) rekomandime nga drejtues të shkollave ose specialistë të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar përkatëse;
- ✓ Fotokopje të noterizuar të librezës së punës.
- ✓ Kopje e dëshmisë së provimit të kualifikimit;
- ✓ Vërtetim që ka 10 (dhjetë) vitet e fundit përvojë pune si mësues në ciklin përkatës;
- ✓ Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm.

Kriteret:

Kriteret që duhet të plotësojnë mësuesit që aspirojnë për t'u bërë vlerësues të testeve:

Kandidati për vlerësues të testeve në provimet kombëtare është mësuesi që:

- a) ushtron profesionin e mësuesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.
- b) ka të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune si mësues.
- c) ka dhënë lëndën përkatëse të paktën 1 (një) herë në të gjitha klasat e nivelit arsimor.
- d) ka të paktën kategorinë e kualifikimit "Mësues i kualifikuar" dhe është vlerësuar në provimin e kualifikimit të mësuesve me të paktën "Mirë".

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- ✓ Formular aplikimi (i cili ndodhet në seksionin njoftime në faqen e QSHA);
- ✓ Jetëshkrimin (CV e aplikantit sipas modelit Europass);
- ✓ 2 (dy) rekomandime nga drejtues të shkollave ose specialistë të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar përkatëse;
- ✓ Fotokopje të noterizuar të librezës së punës;
- ✓ Kopje të dëshmisë së provimit të kualifikimit;
- ✓ Vërtetim që ka 5 (pesë) vitet e fundit përvojë pune si mësues në ciklin përkatës.;
- ✓ Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm.

Procedura e aplikimit:

Qendra e Shërbimeve Arsimore do të pranojë vetëm aplikime që janë përcjellë me rrugë postare në adresën e mëposhtme:

*Qendra e Shërbimeve Arsimore
Blv. Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë*

Afati i dorëzimit të aplikimeve:

Aplikimet mund të dërgohen në rrugë postare nga data 26.11.2025-03.12.2025.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida Myrto

